

**KONTRATE THEMELIMI
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Top News” sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me date 01.03.2021 (dymije e njezet e nje), shtetasja:

Vjollca Hoxha, atësia Shaqir, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, lindur më 23/03/1969, madhore me zotesi të plote për të vepruar, mbajtes i dokumentit personal te identifikimit me nr. 035435055 dhe nr. personal G95323231L.

E cila me cilesine e “Ortakut Themelues”, redaktoi aktin e themelimit, nepemjet te cilit deklaron se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë, ne Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, i ndryshuar, ne ligjin “Per QKB”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin “**Top News**” sh.p.k.

**KREU I
Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është “**Top News**” sh.p.k..

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria “**Top News**” sh.p.k., eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga person fizikë dhe juridike e siperpermendor, e cila përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë sipas kontributit.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarës së saj.

Ortaket gjëzojne kuotën në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë i takon ortakut te vetem znj. Vjollca Hoxha.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka selinë në Shqipëri, Tirane, ne adresën: Rr.17 Nentori, nr.20, Mezez Koder, Kashar Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.



Neni 4 Objekti

-Agjensi publicitare, sherbime monitorimi, sherbime publicitare, shperndarje reklame ne media te shkruara apo elektronike, produhime dhe produksione reklamash dhe shitje te tyre per llogari te te treteve(porositesve), sherbime IT dhe konsulence It .Shperndarje dhe tregetim te materialeve publicitare.Veprimitari ne fushen e medias se shkruar dhe audio vizuale Marketing dhe shperndarje e produhimeve te saj.Perfaqesim te shoqerive te ndryshme shqiptare apo te huaja qe kane objekt te njejtë apo te perafert me ate te kesaj shoqerie.

-Ideim, krijim, realizim identitetesh, produktesh marketingu, sherbime marketingu ,media te shkruar dhe vizive ,promocione, organizim konferencash per nevoja marketingu te klienteve, hartim dhe shperndarje njoftimesh ne cdo media per qellime te shoqerive qe perfaqesojme, shperndarje produktesh marketingu dhe te tjera, studime dhe vezhgime te tregut, konsulence marketingu, realizim media planesh per kete qellim duke patur parasysh focus grupet e interesuara per produktet qe reklamohen , shperndarje ne menyre te studiuar sipas qellimit ne mediat vizive apo te shkruara.

-Import eksport pajisje elektronike, audio-vizive, elekrike, informatike. Shitblerje Kontenti televiziv, shitblerje kapaciteti interneti. Ndertim dhe perpunim i qendrave Data Base. Produksione televizive me ze dhe figure. Evenete Radio Televizive Live Transmetime dhe ritransmetime Audio,Video dhe data.

-Ndertim i rrjeteve Fizike dhe Virtuale dhe te sherbimeve IP/telefoni (Internet Protocol). Krijim i Platformave audio video ofruese, kanaleve televizive dhe transmetim nepermjet satelitit, internetit, sistemit te frekuencave tokesore, ajrore, kabllore.

Neni 5 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore pa afat.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(njeqind mijë)leke dhe eshte i perbere nga 1 kuote.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku themelues:

- Vjollca Hoxha, zoterues i 1 kuote, qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlore te perjithshme 100.000 leke;

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organë Vendimmarres

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave te zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqerise eshte Vjollca Hoxha, e cila do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Administratori ne respekt te dispozitave ligure, mund te kryeje te gjitha operacionet qe do te jne te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishme per te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete,perfshire edhe pagesat apo transfertave bankare qe do te lindin nga kjo maredhenie prane cdo

banke te nivelit te dyte qe operojne ne territorin e Repulikes se Shqiperise apo jashte territorit ne rast nevoje,vete personalisht apo te autorizoje nje te trete me prokure te posacme.

f) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 12

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15
Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemlare me permbajtje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare “*Top News*” sh.p.k. u nenshkruehet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

O R T A K I V E T E M

VJOLLCA HOXHA


Vjollca Hoxha